

DEKRET

Nr. 9763, datë 12.10.2016

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE, BASHKIA
KOLONJË, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 92, germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 20 nëntor 2016, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kolonjë, qarku Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**